

PROCESVERBAL
nga seanca e 25-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
e mbajtur më 1.7. 2022

Anëtarë të pranishëm nga Këshilli i Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr.Metodija Jançeski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr.Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr.Arben Saiti, mr.Argjend Xhelili,Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska,

Të pranishmit e tjerë:/

Z. Petrushevski hapi seancën e 25-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:35 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave në katin e 2-të.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 24-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, e mbajtur më 20.6.2022.
2. Propozim-vendim për marrjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Ivanço Pashoski RADIO LAV SHPKNJP Ohër.
3. Propozim për marrjen e vendimit për Ribalancin e planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022.
4. Propozim për ndryshimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediale Audio dhe Audiovizuale.
5. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin nga seanca e 24-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, e mbajtur më 20.6.2022, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski sqaroi Propozim-vendimin për marrjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Ivanço Pashoski RADIO LAV SHPKNJP Ohër. Ai sqaroi se transmetuesi emeton program në nivel lokal në zonën e komunës së Ohrit. Ai citoj se Agjencia para disa vitesh kishte problem serioz me komunikimin e ndërsjellë edhe në situata kur ASHMA-ja jepte donacione për transmetuesit dhe ky proces zgjati shumë, kështu që donacioni i fundit, kur ishte dashur të jepej në janar të këtij viti, është realizuar pas disa muajsh. Duke pasur parasysh faktin se zotëruesi nuk jeton në Maqedoni por në Gjermani, komunikimi ka ndodhur me vajzën e tij dhe avokatin. Më 19 prill Agjencia është njoftuar nga transmetuesi se i është dërguar vendim për heqjen e lejes për shfrytëzimin e radiofrekuencës nga AKE. Pak ditë më vonë më 27 prill Agjencia mori një njoftim nga AKE se është tërhequr miratimi për shfrytëzimin e radiofrekuencave. RA LAV nuk transmeton program për një kohë të gjatë dhe në pajtim me LSHMAAV, nëse nuk transmeton program brenda 30 ditëve, do të duhet të fillojë procedurë për marrjen e lejes për transmetim në radio. Këshilli i Agjencisë u tregua tolerant sepse kanë kaluar më shumë se 3 muaj nga dita kur Agjencia është njoftuar nga ana e tij, periudhë gjatë së cilës ka pasur mundësinë, si disa transmetues të tjerë të cilëve u është tërhequr miratimi, ndërkohë t'i paguajë dëmshpërblimin AKE-së. dhe t'u kthehet miratimi për shfrytëzim të radiofrekuencave. Fatkeqësisht ky transmetues nuk ka vepruar kështu dhe meqenëse procedura për marrjen e lejes ka filluar dhe për faktin se nuk ka paguar dëmshpërblimin ndaj AKE-së dhe nuk i është kthyer leja për shfrytëzim të radiofrekuencave, propozohet që t'i mirret leja për transmetim në radio.

Z. Petrushevski tha se nuk është aspak e këndshme situata kur i mirret leja një transmetuesi për arsye teknike por kjo është një zgjidhje e detyruar dhe tha se nuk sheh asnjë mundësi tjetër përveç se Këshilli të miratojë vendimin siç është propozuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për marrjen e lejes për transmetim në radio, PA.1 nr. 08-112 i datës 5.1.2015 ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Ivanço Pashoski RADIO LAV SHPKNJP Ohër për shkak se bartësi i lejes ka ndërprerë transmetimin.e shërbimit programor më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare apo arsye të tjera, që paraqet bazë për marrjen e lejes në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet të publikojë vendimin e mësipërm në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në ueb faqen e Agjencisë dhe së paku në dy gazeta ditore, njëra prej të cilave në gjuhën e komunitetit që nuk është shumicë dhe e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Z. Petrushevski tha se shpreson që në të ardhmen të mos ketë shumë raste të tilla për këta transmetues të vegjël.

Pika 3

Z. Trajçevski arsyetoi Propozimin për marrjen e vendimit për Ribalancin e planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022. Ai shpjegoi se sipas LSHMAAV dhe në pajtim me Programit vjetor të punës dhe Planit financiar të ASHMA-së ishte planifikuar për anëtarët e Këshillit të kenë 6 muaj kompensim dhe 6 muaj paga në rast se Kuvendi i zgjedh anëtarët e rinj të ASHMA-së. Për vetë faktin se kjo nuk ndodhi, fondet do ricaktohen për të paguar dëmshpërblimin e anëtarëve të Këshillit për 6 muajt në vijim. Ai ka thënë se të gjitha elementet për ribalancin e Planit Financiar janë dhënë në materialet e propozuara dhe nëse kanë pyetje do t'u përgjigjet udhëheqësi i Sektorit për Financa dhe Logjistikë Goran Radunoviq.

Z. Petrushevski tha se ky është një tjetër vendim i detyruar që Këshilli duhet ta marrë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin miratohet ribalanci i Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2022, Nr. 05-1929/1 datë 5.9.2022.

Me propozimin e ribalancit të Planit Financiar për vitin 2022, shpenzimet totale të planifikuara mbeten në nivelin e përcaktuar më parë, përkatësisht arrijnë në 133.754.238,00 denarë.

Me ribalancin sigurohen mjete financiare në vlerë të përgjithshme prej 4.800.000,00 denarë, të destinuara për:

- rritjen e mjeteve të pagës për kompensim mujor për anëtarët e Këshillit të Agjencisë për një periudhë 6 mujore në vitin 2022.

Sektorit për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet të publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 4

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për ndryshimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensimet e tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Ai shpjegoi se nga Sindikata e Maqedonisë ka Kërkesë jo vetëm drejtuar Agjencisë por edhe të gjitha institucioneve në nivel shtetëror për rritjen lineare të pagës për 2.806,00 denarë në shumën neto. Ai bëri të ditur se lidhur me këtë kërkesë aktualisht edhe para Kuvendit të RMV-së ka grevë ku kërkohet nga deputetët që ta miratojnë këtë propozim për punëtorët. Në ndërkohë disa institucione në shtet që nuk varen drejtpërdrejt nga Buxheti kanë rritur pagat, si komuna e Strumicës, Qyteti i Shkupit, dhe disa ndërmarrje publike, komuna e Gostivarit etj. Në pajtim me Inicativën e dorëzuar nga Organizata Sindikale e ASHMA-së dhe për faktin se ka mjete, propozohet rritja lineare e pagave të të gjithë punëtorëve për 2.806,00 denarë.

Z. Petrushevski tha se këtë vendim e ka nënshkruar personalisht para disa ditësh. Sindikata nga institucioni ku punon është pajtuar me kryetarin e qytetit të Shkupit dhe kjo rritje tashmë është realizuar për 500-600 punëtorë. Ai deklaroi se do ta mbështesë propozimin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, me tekstin e propozuar.

Spektori për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik të përgatisë tekstin e rishikuar (tekst i zbardhur) të Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.

Akti nënligjor i mësipërm të publikohen në tabelën e shpalljeve të Agjencisë.

Pika 5

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr.02-2530/5
08.07.2022
Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI d.v